



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 29.05.2023

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
LEZHË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.6, DATË 16.10.2017
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.6, datë 16.10.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Lezhë”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 24, datë 25.04.2023, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Lezhë, të miratuar me Vendimin Nr.6, datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, të bëhen ndryshime në:
 - *Dokumentin e Rregullores së Planit:*
 - Neni 18 “Ndërrhyrja përmes PDV me faza”, shfuqizohet dhe zëvendësohet nga neni 18 “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm”;
 - Neni 24 “Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ndërtimit në sistemin jourban”, ndryshohet;
 - Pas nenit 24 “Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ndërtimit në sistemin jourban”, shtohet neni 24/1 “Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror”;
 - Neni 26 “Madhësia e Parcelës”, ndryshohet;
 - Pas nenit 38 “Kufizime sektoriale”, shtohet neni 38/1 “Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda Zonave të Mbrojtura dhe Zonave me Përparësi Zhvillimin e Turizmit”;
 - Neni 51 “Drejtime të PINS Bregdetit për fashën 200m”, shfuqizohet dhe zëvendësohet nga neni 51 “Vija blu”;
 - Neni 56 “Varrezat”, ndryshohet;



ILLI MINISTRI

- Pas nenit 72 “Brezat e rezervuara jashtë dhe në qendrat e banuara”, shtohet neni 72/1 “Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C”;
- Neni 74 “Propozime për sistemin e furnizimit me ujë” i shtohet pika “Burimet e ujërave”;
 - Pas nenit 78 “Telekomunikacioni”, shtohet neni 78/1 “Hekurudhat” dhe neni 78/2 “Kanalet vaditëse/Emisaret”;
 - Neni 81 “Zgjidhja e paqartësive bazuar në saktësinë e informacionit”, ndryshohet;
 - Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Lezhë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

1. Ngarkohen Bashkia Lezhë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
2. Ngarkohen Bashkia Lezhë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

